



1394/24  
27.09.24

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagri 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagri 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 18.09.2024, nxjerrë këtë:

### V E N D I M

- I. Mylllet rasti APK-DPKI-06-922/24-A, për zyrtarin e lartë z. Hadrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit publik.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit.

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Hadrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit në ushtimin e funksionit publik të zyrtarëve të lartë të sipërpërmendur, ku theksohet se (*citojmë nga kërkesa*): “*Po iu shkrumjë [...] lidhur me ndarjen buxhetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për projekte e OJQ-ve kosovare në art, kulturë dhe trashëgimi kulturore. Sipas rezultateve të publikuara, lista e përkrahjes përban financimin e disa OJQ-ve, të cilat dyshohet se kanë lidhje me ministrin Hadrulla Çeku [...]. Saktësisht bëhet fjalë për organizatat ‘Ec Ma Ndryshe’ ku ministri Çeku ishte drejtor, OJQ-në ‘Fondacioni Lumbardhi’ ku ministri Çeku ishte bashkëthemelues [...]. A përbëjnë konflikt interesit ndarjet buxhetore të MKRS-së për këto OJQ?*”

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresave zyrtare (APK-DPKI-06/971/24), ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Hadrulla Çeku, lidhur me fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në ushtimin e funksionit publik.

I. Me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të këtij rasti është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë z. Hadrulla Çeku, me ç'rast i njëjtë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, duke theksuar se: '*...që nga tetori i vittit 2017, i kam ndërprerë të gjitha angazhimet e mia në organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe deri sot nuk jam kthyer në këtë sektor asnjëherë pasi që vazhdoj aktivitetin tim politik nga viti 2017, fillimisht në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, e më pas nga 2019-ta në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nga viti 2021 në Qeverinë e Republikës së Kosovës*'. Zyrtari i lartë z. Çeku ka deponuar edhe dokumentacion relevant lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit përkitazi me OJQ-të e sipërpërmendura, ndërsa, në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtutjeshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka mbledhur informacion dhe ka bërë verifikimet e nevojshme të tyre në institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës.

Në deklaratën e zyrtarit të lartë z. Hadrulla Çeku dërguar Agjencisë, theksohet se (*citojmë*):  
*"[...]. Që nga tetori i vittit 2017, nuk jam pjesë e organizatës EC Ma Ndryshe, pasi në atë periudhë kam nisur një angazhim të ri jashtë Republikës së Kosovës. Deri në tetorin e vittit 2017 kam qenë pjesë e stafit të kësaj organizate, ndërsa pas njostimit për angazhimin e ri, paga e fundit që kam pranuar nga EC Ma Ndryshe është e datës 30 tetor 2017. [...]. Nga tetori i vittit 2017 i kam ndërprerë të gjitha angazhimet e mia në organizatat e shoqërisë civile në Kosovë dhe deri sot nuk jam kthyer në këtë sektor pasi vazhdoj aktivitetin tim politik, nga 2017 në Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, ndërsa nga viti 2019 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nga viti 2021 në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Bashkëngjitur mund ta gjeni dëshminë e ndërprerjes së angazhimit edhe në organizatën Fondacioni Lombardhi, ku në momentin e largimit kam qenë i angazhuar si pjesë e Bordit, por asnjëherë nuk kam pasur kompensim financiar për angazhimin tim brenda kësaj organizate. [...].*

*Pra, si në rastin e EC Ma Ndryshe ashtu edhe Fondacionit Lombardhi, bëhet fjalë për organizata serioze të shoqërisë civile, të profilizuara në kulturë e trashëgimi kulturore, që janë mbështetur nga MKRS edhe para se unë të marr detyrën e ministrit, me buxhete të konsiderueshme dhe financim nga donatorë të ndryshëm dhe gjithsesi me ndikim të dëshmuar në fushat ku veprojnë.*

*I gjithë procesi i subvencionimit, respektivisht i mbështetjes së projekteve të kulturës, rinisë, sportit e trashëgimisë kulturore në MKRS bazohet në Rregulloren e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve si dhe Rregulloren e brendshme për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit. Këto akte qartësisht i përcaktojnë edhe procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve të subvencioneve, ndërsa në përbërje të komisioneve (qoftë vlerësues apo i ankesave) parasheh vetëm zyrtarë të administratës dhe profesionistë të jashtëm (pjesëtarë të shoqërisë civile, njoħes të fushës).*

*Në asnjë rast, pjesë e këtyre komisioneve që kanë përbërje profesionale, nuk janë as ministri, as ndonjë anëtar i kabinetit të tij, pasi rregulloret përkatëse e përjashtojnë në tërësi pjesën politike të ministrisë nga procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve përfituese nga skemat e subvencionimit. Për më tepër, të gjitha dokumentet dhe format e vlerësimit individual për secilin aplikues në secilën thirrje publike për subvencionim (përfitues apo jo) mund të gjenden lehtësisht në ministri, pasi ato janë dokumente publike në të cilat garantonohet qasja e*

*gjithë të interesuarve. Çdo dyshim për favorizim a diskriminim mund të verifikohet duke siguruar qasje në dokumentet e aplikimit dhe të vlerësimit nga komisionet përkatëse. [...].*

Agjencia ka analizuar pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit si dhe deponimet tjera të ndërlidhura me këtë rast, deklaratat, sqarimet e palës dhe dokumentacionin e siguruar sipas kërkesës së Agjencisë, si dhe provat tjera të siguruara sipas detyrës zyrtare, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me datë 22 gusht 2024, Organizata Jo-Qeveritare “*Emancipim Civil EC Ma Ndryshe*”, lëshon vërtetim, me të cilin vërteton se: z. Hajrulla Çeku, [...], ka qenë i punësuar si staf në Organizatën Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe) deri në titor të vitit 2017. Largimit nga organizata i ka paraprirë njostimi i z. Çeku për fillimin e angazhimit të tij jashtë Republikës së Kosovës. Paga e fundit për angazhimin e z. Çeku në EC Ma Ndryshe është realizuar më 30 titor 2017;

Me datë 22 gusht 2024, “*Fondacioni Lumbardhi*”, lëshon vërtetim, me të cilin vërteton se: z. Hajrulla Çeku, si njëri nga themeluesit e “*Fondacionit Lumbardhi*”, ka qenë pjesë e ekipit themelues dhe bordit të përkohshëm prej datës 20.04.2015 deri me 14.07.2017. Mbledhja e fundit ku z. Çeku ka marrë pjesë është mbajtur me datën 14.07.2017, kur ai ishte zgjedhur edhe në bordin e parë ekzekutiv të organizatës, po për shkak të emërimit të tij si zv. Ministër në Republikën e Shqipërisë, statusi i tij ka qenë i pezulluar prej datës 08.10.2017, pas të cilës datë ai nuk ka luajtur rolin e anëtarit të bordit dhe nuk ka pas qasje në raportet, dokumentet apo proceset vendimmarrëse të organizatës. Nga data 14.06.2018, bordi ekzekutiv i “*Fondacionit Lumbardhi*” ka konstatuar që z. Hajrulla Çeku nuk ka marrë pjesë në asnje mbledhje të bordit nga data 14.07.2017, dhe ka marrë vendim formal për zëvendësimin e tij me anëtarë të rijnë<sup>1</sup>.

Sa i përket “*Fondacionit Lumbardhi*”, Agjencia kishte trajtuar edhe më parë një pretendimin të jashtëm të një raportuesi të rastit për konflikt të mundshëm të interesit për zyrtarin e lartë z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, lidhur me mbështetjen e MKRS-së dhënë projektit për “*Fondacionin Lumbardhi*”, me ç'rast Agjencia përmes vendimit meritor Nr.: AKK-DPKI-06-3722/22, të datës 29.12.2022, kishte myllur rastin në fjalë, duke konstatuar se, *nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë në fjalë*;

Së fundmi, nga informatat dhe historiku i OJQ-vë: “*Emancipim Civil EC Ma Ndryshe*” dhe “*Fondacioni Lumbardhi*”, të siguruara nga Departamenti përkatës i OJQ-vë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zyrtari i lartë z. Hajrulla Çeku, nuk rezulton të jetë anëtar i ndonjë organi drejtues apo të ketë ndonjë rol apo funksion tjetër drejtues në OJQ-të përkatëse;

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pasi që me rastin e ndarjeve buxhetore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektet e OJQ-ve: “*Emancipim Civil EC Ma Ndryshe*” dhe “*Fondacioni Lumbardhi*”, nuk është rënë ndesh me dispozitat e Ligjit për

<sup>1</sup> Mospjesëmarja (mos-prezenca) e z. Hajrulla Çeku në mbledhje konstatohet edhe në Raportin e mbledhjes së IV-të të Bordit Ekzekutiv (raport i disponueshëm nga APK);

Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konkretisht me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji, ku është përcaktuar se:

*“1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përvçe të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.*

*2. Organizata joqeveritare sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë”.*

Pra, duke qenë se zyrtari i lartë z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, sikurse u konstatua më lartë, nuk është anëtar i ndonjë organi drejtues, e as nuk mban funksione tjera drejtuese në OJQ-të përkatëse, Agjencia konstaton se, pretendimet e ngritura në rastin konkret nuk përbëjnë konflikt të interesit, sikurse, ndalesat apo kufizimet në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, nuk vlejnë në situatën konkrete me rastin e ndarjeve buxhetore të MKRS-së për projektet e OJQ-ve në fjalë.

\* \* \*

Agjencia ka trajtuar gjithashtu edhe kërkesën e njëkohshme të deponuar nga zyrtari i lartë z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes së cilës kërkon që të trajtohet (*citojmë nga kërkesa e tij*): “...një denoncim publik i qytetarit B. Z., i publikuar, me datë 26 qershor 2024, në profilin e tij personal në Facebook. Në këtë tekst, ai pretendon që unë, në cilësinë e ministrit të kulturës, vëllait tim i kam ndarë 257 mijë euro nga fondet publike, duke më akuzuar për hajni. Duke besuar që qytetari B. Z. këtë denoncim publik e ka bërë në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik, dhe jo për ndonjë interes të ngushtë a motiv të ultë dhe duke qenë i bindur që një pretendim kaq serioz nuk mund të mbetet vetëm si status në Facebook, kërkoj nga ju që në kuadër të përgjegjësive tuaja në trajtoni këtë denoncim publik ndaj meje”.

Në takimin e sipërpërmendur të mbajtur në Agjenci, zyrtari i lartë z. Hajrulla Çeku, ka paraqitur argumentet dhe qëndrimin e tij duke kundërshtuar kategorikisht pretendimin e pabazuar të shprehur përmes denoncimit publik nga qytetari B.Z., duke theksuar se, ‘vëllai i tij z. F. Ç., nuk ka qenë asnjeherë anëtar apo staf i organizatës “EC Ma Ndryshe”, dhe si dëshmi që rrezon këtë pretendim të rrejshëm, ua dërgoj dokumentin e lëshuar nga organizata “EC Ma Ndryshe”, përmes së cilës dëshmohet që vëllai im s’ka qenë asnjeherë as anëtar dhe as staf i kësaj organizate’.

Pra, në mbështetje të konstatimeve të mësipërme, z. Hajrulla Çeku dërgon një vërtetim të lëshuar nga OJQ-ja në fjalë, përmes të cilit vërtetohet se: ‘z. F. Ç., me numër personal [...], lindur më [...], ka qenë i angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta në Organizatën Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe). z. F.Ç. nuk ka qenë asnjeherë anëtar apo staf i organizatës “EC Ma Ndryshe”. Angazhimi i tij për shërbime specifike është realizuar përmes shtatë kontratave të veçanta për shërbime në total, gjashë në vitin 2018 dhe një në vitin 2019. [...]’.

Agjencia ka trajtuar kërkesën në fjalë dhe sipas detyrës zyrtare ka bërë verifikimet e nevojshme me institucionet përkatëse (Departamentin përkatës të OJQ-vë në kuadër të Ministrisë s Punëve të Brendshme), dhe me këtë rast nuk ka gjetur se z. F. Ç., vëllai i zyrtarit të lartë z. Hajrulla

Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të ketë qenë anëtar i organit drejtues, të ketë patur ndonjë funksion tjetër drejtues apo të ketë qenë staf i organizatës "EC Ma Ndryshe".

Për më tepër, sikurse u tha më lartë, procesi i subvencionimit, respektivisht i mbështetjes së projekteve të kulturës, rinisë, sportit e trashëgimisë kulturore në MKRS, bazohet në *Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standarde dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Rregulloren e (MKRS) - Nr. 09/2015, për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit.* Këto Rregullore përcaktojnë procedurat e vlerësimit dhe përgjedhjes së përfituesve të subvacioneve, e ku në përbërje të komisioneve, qoftë vlerësues apo të ankesave, parashev vetëm zyrtarë të administratës dhe profesionistë të jashtëm, duke përjashtuar mundësinë që pjesë e këtyre komisioneve profesionale, të jetë ministri, apo ndonjë anëtar i kabinetit të tij.

Prandaj, në rastin konkret, është fakt që F. Ç. është person i afërm (vëllai) i zyrtari të lartë z. Hajrulla Çeku, por, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Ministri Çeku të ketë qenë pjesë e ndonjë vendimmarrjeje në raport me personin e afërt tij, sikurse as F. Ç. - personi i afërt i Ministrit Çeku të ketë qenë pjesë e procesit të aplikimit përmes OJQ-së "EC Ma Ndryshe".


Kësisoj, përvèç se në rastin konkret mungon vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nga zyrtari i lartë z. Hajrulla Çeku (si kusht i domosdoshëm kumulativ), mungon njëkohësisht edhe pjesëmarrja në procesin e aplikimit për projektin në fjalë e personit të afërm (vëllait) të zyrtarit të lartë, çfarë e përjashton konfliktin e interesit, ndalesat apo kufizimet e përcaktuara me dispozitat e sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia nuk ka trajtuar e as paragjykuar procesin e subvencionimit, respektivisht mbështetjes së projekteve të kulturës, rinisë, sportit e trashëgimisë kulturore në MKRS, për sa i përket rregullsisë, procedurave të vlerësimit dhe përgjedhjes së përfituesve të subvacioneve apo aspekteve tjera ligjore, të cilat rregullohen me legjislacion përkatës si dhe akte nënligjore të brendshme (si: *Rregullorja MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standarde dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullorja e (MKRS) - Nr. 09/2015, për subvencionim në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore, rinisë dhe sportit, etj.*), kjo edhe në përputhje me nenin 20, paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku është përcaktuar se: "*Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës.*"

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [*Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit*], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimitarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

  
Ylli BULESHKA  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korruptionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)